

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 97/2024

Datë: 29/04/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) neni 11, nenin 29 dhe nenin 30 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr.14/2023 për fushat dhe përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Përfundimit të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
2. Obligohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Vendimi i'u dërgohet:

- zv. Enver Krasniqi, Drejtor i AAPSK-së;
- Anëtareve të njësisë përgjegjëse;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Arkivit të MD-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë – Ministraskvo Pravde – Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zaplenjenom ili Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered or Confiscated Assets

Data: 29.11.2023

Vendi: Prishtinë

Agjencia për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar duke u bazuar në nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Përformancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, paraqet:

PLANIN E PERFORMANCËS SË AGJENCISË PËR VITIN 2024

A. Pjesa përshkruese e Planit të Përformancës së Agjencisë

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ministria e Drejtësisë, në kuadër të angazhimeve të saja për përmbushjen e aktiviteteve në zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar me ligjin, (Nr.05/L-049), në korrik të vitit 2010, ka themeluar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar e cila Agjenci është ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, mbanë përgjegjësi për ruajtjen dhe administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara që i janë besuar në përkujdesje nga autoritet kompetente. Agjencia kryen funksionet e saj me qëllim që të ofrojë administrim të leverdishëm dhe profesional të pasurisë dhe zhvillon punët e saj me integritet dhe transparencë. Objektivi kryesor i Agjencisë është të administrojë në mënyrë profesionale pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe të bëhet qendër e shkëlqyeshme në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskua.

Agjencia, aktualisht ka të planifikuara dhe buxhetuara njëzet e gjashtë (26) pozita të nëpunësve civil, nga të cilat njëzet e një (21) pozita aktualisht janë të plotësuara.

Agjencia ka të planifikuar **360,110.00** euro buxhet për vitin 2024.

Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetencat e saja, Agjencia është e organizuar në këto njësi themelore organizative:

1. **Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;**
2. **Drejtoreti për Pranimin, Vlerësimin, Ruajtjen e Vlerës dhe Shitjen e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (DPVRShPSK)**

Sektorët

- 2.1 Sektori për Pranim, Vlerësim, Ruajtje të Vlerës së Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (SPVRVShPSK)
- 2.2 Sektori për Shitjen e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (SSHPSK)

3. **Drejtoreti për Punë Normative Juridike dhe Administratë (DPNJA)**

Sektorët.

- 3.1 Sektori i Burimeve Njerëzore (SBNJ)
- 3.2 Sektori për Buxhet dhe Financa (SBF)
- 3.3 Sektori për Punë Normative Juridike (SPNJ)

Agjencia, aktualisht ka një depo qendrore për ruajtjen e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Një pjesë të pasurive e ruan edhe në hapësirën e Qendrës Korrektuese në Smrekonicë, parat dhe metalet e çmuara ruhet në Bankën Qendrore të Kosovës.

2. Hyrje

Plani i performancës së punës së Agjencisë, ka për qëllim të paraqes objektivat së bashku me aktivitetet të cilat Agjencia synon ti realizojë gjatë vitit 2024 dhe të cilat do ti kontribuojnë përmbushjes së mandatit, detyrave dhe përgjegjësive ligjore rreth administrimin të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, e të cilat janë në harmoni edhe me Planin e Punës së Ministrisë së Drejtësisë.

Metodologjia e hartimit të dokumentit është bazuar në analizën e punës paraprake të Agjencisë, analizën e planeve të performancës dhe statistikave mbi pasuritë të cilat i ka administruar Agjencia deri më tani.

Mandati i Agjencisë është të administroj me pasuritë e sekuestruar dhe të konfiskuara me vendim të Gjykatave të Republikës së Kosovës, andaj edhe përmbushja e objektivave rreth administrimit të pasurive është e lidhur ngushtë edhe me punën e organeve tjera, që mund të paraqes sfidë më vete.

Realizimi i investimeve në Depo, duke marrë parasysh buxhetin e ndarë për Agjencinë dhe trendin e rritjes së çmimeve në sferën e materialit ndërtimore, është vështirë i realizueshëm.

3. Përmbledhje e Objektivave

Agjencia në këtë dokument ka paraqitur gjithsej tre (3) objektiva kryesore të cilat synon t'i realizoj me aktivitete.

Objektivat kanë të bëjnë me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në **pajtëm me parimet e ligjshmërisë, ekonomizimit, efikasitetit, transparencës, veprimt me kujdesin e nikoqirit të mirë me përgjegjësi dhe profesionalizëm**, avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, infrastrukturës në depo si dhe **ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërinstytucional**.

Me përmbushjen e këtyre objektivave synohet të kompletohet stafi rreth pozitive të lira, të avancohet infrastruktura e mirëmbajtjes së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe të ndikohet në ruajtjen e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

4. Ndikimi buxhetor

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar ka të planifikuar për vitin 2024, buxhetin në vlerë prej: 360,110.00 euro, e cila është e shpërndarë në këto kategori:

1. Paga dhe mëditje 190,930.00 euro;
2. Mallra dhe shërbime 154,180.00 euro;
3. Komunali 15,000.00 euro dhe,
4. Kapitale 0.00 euro

Duhet theksuar që për shkak të detyrave dhe përgjegjësisve të institucionit mund të këtë tejkalim të buxhetit, ku varësisht nga numri i vendimeve të ardhura nga organet kompetente për zbatimin e ligjit, Agjencia duhet të kërkojë buxhet shtesë për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Objektivat	Treguesi(t)	Departamenti Përgjegjës	Detyrat	Rezultatet (Autputet)	Alokimi financiar	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike
1. Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	<p>1. Numri i vendimeve të ekzekutuara nga gjykata</p> <p>2. Vlerësimi, ruajtja e vlerës së pasurive në administrim të Agjencisë</p> <p>3. Realizimi i ankandeve publike - të hyrat e realizuara nga shitjet, dhënie me qira.</p> <p>4. Dhënia në shfrytëzim institucioneve pasuritë e konfiskuara.</p>	DPVRS HPSK	<p>1. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave</p> <p>2. Evidentimi i pasurive në administrim</p> <p>3. Vlerësimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara</p> <p>4. Ruajtja e vlerës së pasurive</p> <p>5. Shitja, kthimi, vlerësimi, dhënia me qira, dhënia në shfrytëzim e pasurive, si dhe asgjësimi i tyre</p>	<p>1. Pranimi i pasurive në administrim</p> <p>2. Vlerësimi i pasurive në administrim</p> <p>3. Mirëmbajtja e pasurive në administrim</p> <p>4. Regjistrimi i pasurive në administrim në bazën e të dhënave</p> <p>5. Numri i ankandeve të realizuara dhe ekzekutimi i vendimeve tjera të gjykatës.</p>	Buxheti i Kosovës Vlera 122,000.00	Plani strategjik i AAPSK-së 2023-2025

<p>2. Avancimi i Burimeve Njerëzore dhe Infrastrukturës në Depo</p>	<p>1. Pozitat e rekrutuara dhe numri i trajnimeve</p> <p>2. Përfundimi i sallës së ankandeve</p>	<p>DPNJA dhe DPVRSH PSK</p>	<p>1. Rekrutimi i pozitave të lira dhe organizimi i pjesëmarrjes së stafit në trajnime dhe përmirësimi i kushteve të punës</p> <p>2. Inventarizimi i sallës së ankandeve në depon e AAPSK-së</p> <p>3. Korrespondenca me Gjykatat e Kosovës, dhe hartimi i dokumenteve për funksionim të Institucionit</p> <p>4. Krijimi i platformës për zhvillimin e ankandeve online</p> <p>5. Rishikimi i planit strategjik të AAPSK-së</p> <p>6. Rishikimin e PSV për pranimin, vlerësimin, ruajtjen, asgjësimin dhe shitjen e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara</p> <p>7. Menaxhimi i Buxhetit të AAPSK-së</p>	<p>1. Plotësimi i pozitave</p> <p>2. Salla funksionale për zhvillimin e ankandeve publike ne Depo;</p> <p>3. Realizimi i ankandeve online</p>	<p>Buxheti i Kosovës Vlera 24,100.00</p> <p>Donatorët</p>	<p>Plani strategjik i AAPSK-së 2023-2025</p> <p>Plani Zhvillimor i Ministrisë së Drejtësisë 2023-2025</p>
<p>3. Bashkëpunimi ndërinstytucional me institucionet vendore dhe ndërkombëtare lidhur me administrimin e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara</p>	<p>1. Takime me institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera lidhur me pasuritë e sekuestruara dhe te konfiskuara</p> <p>2. Takimet me institucionet relevante ndërkombëtare lidhur me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara</p>	<p>DPNJA dhe DPVRSH PSK</p>	<p>1. Aktivitetet e përbashkëta në fushën e sekuestrimit dhe të konfiskimit me aktorët relevant</p> <p>2. Aktivitetet e përbashkëta me organet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës;</p> <p>3. Koordinimi me projektet mbështetëse dhe institucionet ndërkombëtare</p> <p>4. Vendosja e formave të bashkëpunimit dhe shkëmbimit te përvojave me institucionet relevante ndërkombëtare lidhur me administrimin e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara</p>	<p>Ngritja profesionale</p>	<p>Buxheti i Kosovës Vlera 21,000.00</p>	<p>Plani strategjik i AAPSK-së 2023-2025</p>